



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E KULTURËS, ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

SPECIFIKIME TEKNIKE


Objekti i prokurimit: “Pajisja dhe mobilimi i kopshtit dhe çerdhes, ish shkolla Veterinare”

Projekti: “Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit”,

financuar në kuadër të Skemës së Granteve “BE për Bashkitë” (EU4M)

1. Tavolinë Loje

Tavolinë për zhvillimin e aktiviteteve dhe lodrave të ndryshme. Kjo tavolinë duhet të jetë ngjyrë druri natyral. Të gjithë elementët e tavolinës duhet të jenë të punuara me harqe për të evituar dëmtime të ndryshme të fëmijëve. Në këtë tavolinë është përlogaritur të ulen gjashtë fëmijë. Materialet që duhet të përdoren në prodhimin e tavolinës nuk duhet të jenë alergjik dhe të dëmshëm për shëndetin e fëmijëve.



2. Tavolinë Rrethore Ngrënie

Tavolinë rrethore me diametër 60cm, për ngrënie për fëmijë të moshës së çerdhes. Këto tavolina duhet të jenë me ngjyra të ndryshme. Të gjithë elementët e tavolinës duhet të jenë të punuara me harqe për të evituar dëmtime të ndryshme të fëmijëve. Në këtë tavolinë është përlogaritur të ulen katër fëmijë. Materiali i skeletit tub i rumbullakët 32 mm dhe 30x20 mm korniza mbajtëse e suprines, për të shmangur gërvishtjet e fëmijëve, i lyer me pudër elektrostатike. Pjesët mbështetëse të këmbëve duhet të jenë me tapa plastike. Syprina e saj MDF e laminuar me trashësi 18 mm, veshja perimetrale me ABC ose gominë të rumbullakosur. I gjithë montimi i saj bëhet në pjesët e fshehura të skeletit, të mbuluara me tapa plastike. Asnjë material nuk duhet të jetë alergjik dhe i dëmshëm për shëndetin e fëmijëve.



3. Tavolinë Rrethore Ngrënie

Tavolinë rrethore me diametër 80cm, për ngrënie për fëmijë të moshës së kopshtit. Këto tavolina duhet të jenë me ngjyra të ndryshme. Të gjithë elementët e tavolinës duhet të jenë të punuara me harqe për të evituar dëmtime të ndryshme të fëmijëve. Në këtë tavolinë është përlogaritur të ulen katër fëmijë. Materiali i skeletit tub i rumbullakët 32 mm dhe 30x20 mm korniza mbajtëse e syprines, për të shmangur gërvishtjet e fëmijëve, i lyer me pudër elektrostатike. Pjesët mbështetëse të këmbëve duhet të jenë me tapa plastike në mënyrë që të shmangim gërvishtjen e parketit. Suprina e saj MDF e laminuar me trashësi 18 mm, veshja perimetrale me ABC ose gominë të rumbullakosur. I gjithë montimi i saj bëhet në pjesët e fshehura të skeletit, të mbuluara me tapa plastike. Asnjë material nuk duhet të jetë alergjik dhe i dëmshëm për shëndetin e fëmijëve.



4. Karrige për Fëmijët e Çerdhes dhe Kopshtit

Karrige druri për fëmijë të moshës së çerdhes dhe kopshtit me tri përmasa të ndryshme në lartësinë e ndenjësës: gjerësi 39cm, thellësi 36cm, lartësi totale 67cm, lartësi e ndenjësës 26, cm, 31 cm dhe 34 cm, dhe thellësi e ndenjësës 26 cm. Të gjithë elementët e karriges duhet të jenë të punuar me harqe për të evituar dëmtime të ndryshme të fëmijëve. Kjo karrige duhet të ketë ngjyrë druri natyral. Materialet që duhet të përdoren në prodhimin e karriges nuk duhet të jenë alergjik dhe të dëmshëm për shëndetin e fëmijëve.



5. Govatë e pajisur me tavolinë ndërrimi për fëmijët e çerdhes

Govatë që shërben për larjen, tharjen dhe veshjen e fëmijëve të moshës së çerdhes, nga 0-12 muajsh. Pjesa e sipërme e tavolinës është e veshur me material të butë dhe të papërshkueshëm nga uji, me pjesët anësore të ngritura për të siguruar fëmijët. Pjesa e govatës është shumë komode me formë anatomike, me shtresë të gomuar në pjesën fundore.



6. Krevat për Fëmijët e Kopshtit

Krevat për fëmijë të moshës së kopshtit me përmasa: gjerësi 56cm, gjatësi 132cm dhe lartësi 15 cm. Struktura është e ndërtuar me tuba çeliku, ndërsa pjesa ku shtrihen fëmijët është material tip rrjete. Kjo strukturë shërben për vendosjen një mbi një të krevateve dhe spostimin e tyre lehtësisht. Të gjithë elementët e krevatit duhet të jenë të punuar me harqe për të evituar dëmtime të ndryshme të fëmijëve. Materialet që duhet të përdoren në prodhimin e krevatit nuk duhet të jenë alergjik dhe të dëmshëm për shëndetin e fëmijëve.



7. Krevat për Fëmijët e Çerdhes

Krevat druri për fëmijë të moshës së çerdhes me përmasa: gjerësi 60cm, gjatësi 125cm. Pjesa mbrojtëse e krevatit e cila është e ndërtuar me shirita druri dhe bazamenti ku vendoset dysheku janë të lëvizshëm. Kjo ndihmon për vendosjen lehtësisht të fëmijëve në krevat. Me katër rrota, 2 prej të cilave me sistem frenimi. Të gjithë elementët e krevatit duhet të jenë të punuar me harqe për të evituar dëmtime të ndryshme të fëmijëve. Ky krevat duhet të ketë ngjyrë të bardhë. Materialet që duhet të përdoren në prodhimin e krevatit nuk duhet të jenë alergjik dhe të dëmshëm për shëndetin e fëmijëve.



8. Dyshek për Krevatet e Çerdhes

Dyshek për fëmijë të moshës së çerdhes, përkatësisht me përmasa: gjerësi 60cm dhe gjatësi 120cm. Ky dyshek duhet të ketë mbushje ekologjike, materiali veshës i dyshekut duhet të jetë joalergjik, higjenik dhe të mos e irritojë lëkurën e fëmijës.



9. Set çarçafësh për fëmijët e Çerdhes dhe Kopshtit

Set çarçafësh për fëmijë të moshës së çerdhes dhe kopshtit, përkatësisht me përmasa: gjerësi 115cm dhe gjatësi 175cm. Keto çarçafe duhet të jenë 100 % pambuk, joalergjik, higjenik dhe të mos e irritojë lëkurën e fëmijës.



10. Jastëk memory për fëmijë

Jastëk për fëmijë të moshës së çerdhes dhe kopshtit, përkatësisht me përmasa: gjerësi 40cm dhe gjatësi 60cm. Duhet të kenë mbushje ekologjike, materiali veshës duhet të jetë joalergjik, higjienik dhe të mos e irrirojë lëkurën e fëmijës.



11. Batanije për fëmijë

Batanije për fëmijë të moshës së çerdhes dhe kopshtit, përkatësisht me përmasa: gjerësi 110cm dhe gjatësi 140cm. Kjo batanije me material poliester, duhet të jetë ekologjike, materiali joalergjik, higjienik dhe të mos e irrirojë lëkurën e fëmijës.



12. Raft për vendosjen e lodrave

Raft për vendosjen e lodrave me përmasa 200cm x 40cm x 80 cm. Struktura: melamine 16mm me veshje perimetrale PVC, ngjyra e bardhë. Është funksional dhe në të mund të vendosen kasone të ndryshëm plastik të mbushura me lodra fëmijësh. Duhet të ketë një pamje bashkohore dhe një punim cilësor. Materialet që duhet të përdoren në prodhimin e raftit nuk duhet të jenë alergjik dhe të dëmshëm për shëndetin e fëmijëve.



13. Raft Garderobë

Raft për vendosjen e rrobave me përmasa 120cm x 40cm x 40 cm pjesa e poshtme dhe 120cmx10cmx80cm pjesa e sipërme. Materiali me të cilin duhet të realizohet rafti është m.d.f. ngjyrë druri natyral. Duhet të ketë një pamje bashkohore dhe një punim cilësor. Materialet që duhet të përdoren në prodhimin e stolit nuk duhet të jenë alergjik dhe të dëmshëm për shëndetin e fëmijëve. Të gjithë elementët e krevatit duhet të jenë të punuar me harqe për të evituar dëmtime të ndryshme të fëmijëve.



14. Kosh "play-station"

Kosh plastik për ti siguruar fëmijëve të moshës së çerdhes (0+) një kënd ku mund të lozin të mbrojtur, përkatësisht me përmasa: 100cmx 90cmx75cm. Ky kosh duhet të ketë pjesët anësore me rrjetë për të evituar dëmtimet e fëmijëve dhe të mund të mbyllet në rastet kur nuk përdoret. Materialet e koshit duhet të jenë ekologjike, joalergjik, higjenik dhe të mos e irritojë lëkurën e fëmijës.



15. Tapet "puzzle"

Tapet për fëmijëve të moshës së çerdhes dhe të kopështit (0+), me përmasa totale: 60cmx60cmx1cm. Ky tapet mundëson fëmijët të lozin në të duke e çmontuar dhe montuar përsëri me forma nga më të ndryshmet . Është i lehtë në përdorim dhe i lehtë në pastrim. Materialet e tapetit duhet të jenë ekologjike, joalergjike, jo-toksike, higjenike, pa aromë dhe të mos e irritojë lëkurën e fëmijës. Ky tapet nuk është i rrëshqitshëm.



16. Lodër plastike lëkundëse për ambientet e brendshme

Lodër plastike lëkundëse për 1-4 vjeç, e përshtatshme për ambiente të brendshme. Mbështetje në 4 pika. Materiale të sigurta dhe të standardizuara për fëmijë. Dizajne dhe personazhe të ndryshme. Ngarkesa maksimale 40 kg.



17. Jastek/ndenje për fëmijë me ngjyra (emoji)

Jastekë dekorativ, por edhe me funksion ndenje për fëmijë të dizajnuar me emoji. I japin ambientit të kopshtit dhe çerdhes larmi ngjyrash. Të mbushura me filtër. Materiale të sigurta për fëmijë. Diametër 40-70 cm.

